

28 nëntor 2025,
Prishtinë

Vendim i Bordit të FBK-së i datës 28.11.2025, Prishtinë

Miratimi i organizimit të Superkupës së Kosovës për Femra 2025

Në përputhje me kompetencat e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që dalin nga Statuti, gjegjësisht neni 24, më 28.11.2025, Bordi i FBK-së ka miratuar organizimin e Superkupës së Kosovës për Femra në bashkëpunim me KBF Peja 03, e planifikuar të zhvillohet nga 02 deri më 06 dhjetor 2025.

Ky vendim bazohet në propozimin zyrtar të paraqitur nga KBF Peja 03, i cili përmban të gjitha elementet e nevojshme organizative, teknike dhe logjistike, duke përfshirë:

- Përmbushjen e kriterëve financiarë dhe obligimeve ndaj FBK-së;
- Sigurimin e palestrës dhe kushteve teknike në përputhje me standardet e FIBA-s dhe aktet normative të FBK-së;
- Respektimin e udhëzuesit të marketingut dhe protokolleve të transmetimit televiziv;
- Garantimin e sigurisë dhe menaxhimit të eventit sipas kërkesave të udhëzuesit të FBK-së;
- Strukturën organizative, si dhe organizimin e ceremonisë së hapjes dhe mbylljes së turneut.

Në vlerësimin e tij, Bordi ka marrë parasysh edhe përvojën e KBF Peja 03 në organizimin e ngjarjeve të rëndësishme, përfshirë Superkupën e Kosovës 2024 dhe ndeshjet ndërkombëtare të FIBA EuroCup Women, duke vlerësuar kapacitetin e tyre profesional për realizimin e suksesshëm të këtij eventit.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben FETAHU



Federata e Basketbollit të Kosovës

